

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISË TREGTARE  
"DGA Construction "SH.P.K**

**Elbasan më 16 tetor 2022**

Sot, në Elbasan, më datë 16/10/2022 (dymijë e njëzetë e dy), Ortaku themelues

1. **Z. Gëzim ALLA**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14/09/1982, banues në Lgj "11 Nentori", Rruga "Emin Haxhiademi", Nd 16, H1, ZK 8525, Elbasan, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr. BF5217878 dhe Numër personal NID. I20914070S . nënshkruan themelimin e shoqërisë "DGA Construction "SH.P.K në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, me kushtet si vijon:

**NENI 1**

**Emri i shoqërisë**

1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "DGA Construction " SH.P.K

1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë, të përfaqësuar në kuota.

1.3 Ortaku themelues Z. Gëzim ALLA, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14/09/1982, banues në Lgj "11 Nentori", Rruga "Emin Haxhiademi", Nd 16, H1, ZK 8525, Elbasan, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr. BF5217878 dhe Numër personal NID. I20914070S .

**NENI 2**

**Forma e shoqërisë**

2.1. Forma e shoqërisë tregtare "DGA Construction " SH.P.K (në vazhdim referuar si "Shoqëria) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar)

2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3**

**Selia e shoqërisë**

3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Elbasan, në adresën: Lgj 11 Nentori, Rruga Defrimi, Nr. 22/268-ND, ZK 8525, Elbasan

3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë.

3.3. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3.4. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon [allagezim1982@gmail.com](mailto:allagezim1982@gmail.com)

**NENI 4**

**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posacëm.

## **Neni 5: Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm por duke mos u kufizuar:

1. Ndërmarrje ndertimi për vete dhe për llogari të të tremeve në kryerjen e veprimtarive ndërtimore që lidhen me to.
2. Ndërtim, zbatim e rikonstrukcion të godinave të gjitha llojeve, rruge të çdo kategorie, sheshe të çdo kategorie, shtrim pllaka , shtrim autoblokante.
3. Rinovimi, modernizimi, restaurimi, rindërtimi dhe përfundimi i ndërtesave dhe banesave civile, tregtare, sociale, dhe çdo gjë tjetër e natyrshme në fushën e ndërtimit dhe rinovimit të ndërtesave, duke përfshirë prodhimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen në funksionim të sistemeve alternative të energjisë në përgjithësi;
4. Blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë si dhe import dhe eksport të materialeve të ndërtimit.
5. Shoqëria mund të vazhdojë edhe me nënkontraktimin e punëve të ndërmarrja, dhe nga ana tjetër, duke qenë nënkontraktore, mund të blejë dhe më pas të rishesë punimet dhe strukturat mbështetëse të ndërtuara dhe jo të ndërtuara, të blejë e të shesë prona dhe njësi banimi, të blejë e të shesë tokë.
5. Për të arritur qëllimin e shoqërisë, në baza instrumentale dhe detyësore, dhe në çdo rast jo në radhë të parë, shoqëria mund të kryejë të gjitha transaksionet tregtare, industriale dhe të pasurive të paluajtshme që do të gjykohen të nevojshme, duke përfshirë emetimin dhe/ose marrjen e garancive, ose të llojeve të tjera të kolateralit, si në emër të shoqërisë, ashtu edhe në favor të palëve të treta dhe në emër të palëve të treta. Shoqëria mund të fitojë drejtpërdrejt ose terthorazi interesa ose aksione në shoqëri ose biznese të tjera.
6. Kompania do të jetë në gjendje të marrë dhe të kryejë pagesa me para elektronike, të kryejë dhe operacione ndryshimi blloku dhe programe financiare, për vete dhe për llogari të tremeve. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare dhe financiare, të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë.
7. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektivit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë, të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

## **Neni 6 Kapitali themeltar**

- 6.1. Kapitali fillestar i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë lekë), i ndarë në 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100.000 lekë ( njëqind mijë lekë).
- 6.2. Ortaku themelues Z. Gëzim Mexhit Alla është zotërues i 1 (nje) kuotë me vlerë të përgjithshme 100.000 ( njëqind mijë lekë) që përbën 100 % të kapitalit bazë të shoqërisë
- 6.3. Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku themelues në total dhe do të shlyhet prej tij në rrugë bankare.

## **Neni 7 Organet drejtuese**

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; organet drejtuese të shoqërisë janë :
  - a. Asambleja e Ortakeve – organi më i lartë vendimmarrës



- b. Administratori- organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.  
7.2. Mënyra e funksionimit dhe organizimit të tyre është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Administrimi**

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga administratorët e saj të cilët zgjidhen me një afat 5 vjecar me të drejtë rizgjedhjeje, me datë fillimi datën e regjistrimit të shoqërisë në QKB.
- 8.2. Administrator i shoqërisë do të jetë :  
*- Z. Gëzim ALLA , shtetas shqiptar, i datëlindjes 14/09/1982, banues në Lgj "11 Nentori", Rruga "Emin Haxhiademi", Nd 16, H1, ZK 8525 , Elbasan, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr. BF5217878 dhe Numër personal NID. I20914070S .*
- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

## **Neni 9**

### **Baza Ligjore**

- 9.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me statutin e firmosur nga themeluesit e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 9.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dheshoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 10**

### **Regjistrimi i shoqërisë**

- 10.1.** Shoqëria do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe një apo disa persona të autorizuar prej tij për këtë qëllim , sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 11**

### **Dispozita përfundimtare**

- 11.1. Ky Akt Themelimi u përpilua në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqip, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

## **O R T A K U**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"DGA Construction " SH.P.K

Gëzim Alla

